



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 176 Datë 03.08.2018**

**MBI**

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË  
FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN  
KORRIK 2018**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 86, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin korrik 2018,

**Konstatohet se:**

- OSHEE sh.a. me anë të shkresës Nr. 15209 Prot., datë 01.08.2018 (Protokolluar në ERE me Nr. 451/1 datë 01.08.2018), dërgoi në ERE aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2018.
- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të Vendimit 144, datë 25.06.2018 mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” neni 8 i rishikuar i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s.
- Në përfundim, bazuar në informacionin e paraqitur në këtë aplikim, OSHEE sh.a. kërkon një çmim prej 12.86 lekë/kWh për furnizimin me energji elektrike nga FMF për muajin Korrik 2018.

- Të dhënat e paraqitura nga OSHEE sh.a. bazohen në:
  - ✓ çmimi maksimal i blerjes së energjisë elektrike per periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE) është e barabartë me çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike per vitin 2018 prej 8.5652 Lekë/kWh ,e riskun 3% mbi çmimin e blerjes; çmimi maksimal rezulton 8.82 Lekë/kWh.
  - ✓ Kosto Administrative Gjithsej (CA) rezulton 1.79 Lekë/ kWh
  - ✓ Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratur me Vendimin Nr. 210, Datë 28.12.2017 *“Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2018”* është 0.75 Lek/kWh
  - ✓ Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratur me Vendimin Nr. 211, Datë 28.12.2017 *“Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”* është 1.5 Lek/kWh.
  
- Vëme në dukje se OSHEE sh.a. edhe për muajin Korrik 2018, vazhdon të mos paraqesi informacion mbi koston e disbalancave që shkaktohen nga klientët që furnizohen nga FMF, dhe nuk ka deklaruar që i ka faturuar klientët që furnizohen nga FMF për këto kosto, ashtu siç kemi vërejtur dhe për periudhën Janar – Qershor 2018.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12.86 lekë/kWh për muajin Korrik 2018
  
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.